



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi i Shqipërisë

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë më 12.7.2018

Dokument Parlamentar

R A P O R T

“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN, ORGANIKËN DHE KATEGORIZIMIN E PAGAVE TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”

I - Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 10.07.2018, në mbështetje të nenit 18, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në vijim KDIMDP; “*Për miratimin e ndryshimeve në Strukturën, Organikën dhe Kategorizimit të Pagave të Zyrës së Komisionerit*”. Në mbledhje morën pjesë Komisioneri, z. Besnik Dervishi, si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave.

II - Baza ligjore e propozimit:

Kërkesa për ndryshime në strukturën, organikën dhe kategorizimin e pagave të (KDIMDP)-së është depozituar në Kuvend në përputhje me kërkesat e nenit 10, pika 1, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe në nenin 37, të ligjit nr 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar. Në aspektin procedural janë respektuar kërkesat e Rregullores së Kuvendit.

III - Komisioni pasi u njoh me dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi kërkesat dhe argumentimin e Komisionerit për ndryshime në strukturë, konstatoi se:

Në ligjin nr.109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i është akorduar shtesë në fondin e pagave për 2 (dy), punonjës dhe konkretisht nga 35 punonjës që ka aktualisht Zyra e KDIMDP, ligji për “Buxhetin e vitit 2018”, parashikon një numër prej 37 punonjësish.

Të dy punonjësit do jenë pjesë e “*Drejtorisë për të Drejtën e Informimit*”, e cila është krijuar pas ndryshimeve ligjore që janë bërë në vitin 2014, ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Ndryshimet e reja strukturore parashikojnë që “*Drejtoria për të Drejtën e Informimit*”, të ketë në përbërje të saj **6 (gjashtë) nëpunës, 1 (një drejtor) dhe 5 (pesë) inspektorë**.

Në zbatim të detyrimit që rrjedh nga pika 31, e VKM, Nr. 474, datë 16.06.2011. “*Për përcaktimin e Standardeve të Procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të Strukturave Organizative të Institucioneve të Administratës Publike*”, ku përcaktohet se : **“Në rastin e ndryshimit të strukture së institucioneve të pavarura, Kuvendi kërkon mendimin e detyrueshëm të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave”**, Zyra e Komisioneri i ka paraprirë procesit, duke depozituar kërkesën në Kuvend për ndryshime në strukturë së bashku me mendimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, dhe konkretisht:

Nga dokumentacioni i depozituar në Kuvend konstatohet se Zyra e Komisionerit ka marrë mendimin paraprak të Departamentit të Administratës Publike, i cili është shprehur parimisht dakord me kërkesën për ndryshime në strukturën e KDIMDP.

Gjithashtu Ministria e Financave, është shprehur dakord në lidhje me kërkesën për ndryshime në strukturë, duke qënë se në ligjin nr 109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, janë akorduar fondet e shpenzimeve të personelit prej 37 punonjësish, për pasojë ndryshimi në strukturë nuk prodhon efekte financiare shtesë.

IV - Përfundime të raportit:

Komisioni i Ligjeve, pas diskutimit të relatores së çështjes deputetes Vasilika Hysi, pyetjeve dhe diskutimeve të deputetëve, vlerësoi se struktura dhe organika, si dhe numri i punonjësve të propozuar për strukturën e re të (KDIMDP)-së, janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Komisioni vlerësoi se ndryshimet e propozuara në strukturën e KDIMDP, janë të domosdoshme për mirëfunksionimin e këtij institucioni, që mbikëqyrë zbatimin e ligjshmërisë së dy të drejtave, të drejtës për informin dhe të drejtën e privatësisë.

Në këto kusht Komisioni i Ligjeve, miratoj projekt-strukturën e paraqitur nga “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, duke ia përcjellur seancës plenare për votim.

Bashkëlidhur relacionit të Komisionit të Ligjeve, projekt-vendimi për “Strukturën dhe Organikën, Kategorizimin e Pagave” të zyrës së “Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

KRYETARI

Ulsi MANJA


RELATORE

Vasilika HYSI

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Lidhja nr. 1



Lidhja nr. 2

Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
I. Komisioneri		
I. Komisioneri	1	I-D Ligji nr. 9584, datë 17.7.2006, i ndryshuar
II Kabineti		VKM. 187 datë 8.3.2017
Këshilltar	1	II - b
Sekretar	1	
III. Drejtoria për të Drejtën e Informimit		
Drejtor	1	II-b
Inspektorë	5	III-a
IV. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale		
Drejtor	1	II-b
Inspektorë	4	III-a
V. Drejtoria e Hetimit Administrativ		
Drejtor	1	II-b
Inspektorë	4	III-a
VI. Drejtoria e Çështjeve Juridike		
Drejtor	1	II-b
VI/I. Sektori i Legjislacionit		
Shef sektori	1	III - a
Specialistë	2	III - b
VI/II. Sektori i Procedurave Administrative		
Inspektorë	2	III - a
VII. Drejtoria e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë		

Drejtor	1	II-b
VII/I. Sektori i Komunikimit me Median dhe Publikun		
Specialistë	2	III-b
VII/II. Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve		
Shef sektori	1	III-a
Specialistë	2	III-b
VIII. Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe Financës		
Drejtor	1	II-b
Specialist i burimeve njerëzore/ analist i punës	1	III-b
Specialist IT	1	III-b
Specialist buxhet-financë /shërbime	1	III-b
Specialist redaktor/protokoll /arkiv	1	IV-a
Shofer	1	Kl. IV (VKM nr.717, datë 23.6.2009, i ndryshuar)
Gjithsej	37 punonjës	